



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA/ REPUBLIC OF KOSOVO
KOMUNA E GJAKOVËS
OPŠTINA DJAKOVICA/MUNICIPALITY OF GJAKOVA



Republika e Kosovës - Republika Kosovo - Republic of Kosovo
Komuna e Gjakovës - Opština Djakovica - Municipality of Gjakova

ARKIVA DALËSE
IZLAZNE ARCHIVE
OUTPUT ARCHIVES

Nr./No./Br./Inv. 01-470/13-18585
Data/Datum/Data 23.12.2024
Gjakovë - Djakovica - Gjakova

Njësia e Auditimit të Brendshëm në Komunën e Gjakovës

PLANI STRATEGJIK

2025 -2027

23/12/2024

Plani strategjik prezanton objektivat kryesore, prioritetet dhe fushëveprimin e aktiviteteve të auditimit të brendshëm në Komunën e Gjakovës, për periudhën 2025 - 2027, që janë në pajtueshmëri me qëllimet dhe planet e organizatës të përcaktuara në bazë të Statutit të Komunës, Skemën Organizative, Kornizës Afatmesme Buxhetore trevjeçare (2025 - 2027), Ligjin për Financat e Pushtetit Lokal, Ligjin mbi Prokurimin Publik, rregulloret dhe udhëzimet e aplikueshme të thesarit si dhe raportet paraprake të auditimit të brendshëm dhe Zyres Komëtare të Auditimit.

Plani strategjik është zhvilluar në bazë të vlerësimit të rrezikut dhe në pajtim me Ligjin për Kontrollin e Brendshëm të Financave Publike, standardet e auditimit të brendshëm, kodin e etikës së auditorëve të brendshëm, Statutin e Njësise së Auditimit të Brendshëm (NJAB), dhe metodologjinë për Auditimin e Brendshëm (AB) në sektorin publik të përgatitur nga Njësia Qendrore Harmonizuese për Auditimin e Brendshëm (NJQHAB).

Plani strategjik siguron bazat për zhvillimin e planeve vjetore të aktiviteteve të auditimit të brendshëm të cilat do të përkufizojnë temën, fushëveprimin, objektivat dhe kërkesat e burimeve për implementimin e secilës detyrë të auditimit.

1.2 Struktura, funksionet dhe fushëveprimi i auditimit të brendshëm në organizatë

Funksioni i auditimit të brendshëm në organizatë realizohet nga Njësia e Auditimit të Brendshëm, e cila është themeluar në sajë të Ligjit 03/L-128 mbi Auditimin e Brendshëm. Strukturi dhe funksionimi aktual i NJAB-së bëhet në bazë të Ligjit 06/L-021 për Kontrollin e Brendshëm të Financave Publike dhe Rregulloren nr. 01/2019 për Themelimin dhe Zbatimin e Funksionit të AB-së në Subjektin e Sektorit Publik (SSP), përashihet që NJAB të ketë s' paku tre auditor.

NJAB ka pavarësi funksionale për planifikim, kryerje dhe raportimin e aktiviteteve të auditimit të brendshëm dhe jo detyra tjera në kuadër të SSP që nuk lidhen me funksionin e auditimit të brendshëm. Auditorët e brendshëm gjatë kryerjes së auditimit mbështesin legjislacionin në fuqi, kodin e etikës, kërkesat specifike të ligjeve si dhe kërkesat relevante të publikuara nga NJQHAB.

1.3. Azhurnimi i planit strategjik

Plani strategjik duhet të rishikohet dhe azhurnohet çdo vit për të reflektuar çdo ndryshim që ndodhë në objektivat, prioritetet dhe aktivitetet e Komunës dhe në bazë të vlerësimit të rrezikut. Plani përfshinë edhe rivlerësimin gjithëpërfshirës tre vjeçar. Pas skadimit të

periudhës trevjeçare të mbuluar nga ky plan strategjik, kryhet një ri-vlerësim gjithëpërfshirës i rrezikut.

Udhëheqësi i NjAB-së mund ta azhurnojë më shpesh Planin strategjik sipas gjykimit të tij/saj, sipas nevojës. Çdo ndryshim i Planit strategjik duhet të miratohet nga Kryetari i Komunës dhe Komiteti i Auditimit (KA).

II. TË KUPTUARIT E AKTIVITETEVE TË ORGANIZATËS

Kryesisht Planin strategjik i NjAB është hartuar në bazë të vlerësimit nga Udhëheqësi i NjAB për fushat më me rrezik të bazuara në Legjislacionin në fuqi dhe nga nevoja për përcaktimin e Universit të auditimit.

NJAB ka filluar procesin e planifikimit strategjik duke bërë një rishikim të qëllimeve, njësive strukturale dhe aktiviteteve të organizatës. Rishikimi është bazuar në informacionet e grumbulluara përmes takimeve, analiza e rezultateve të dalura nga raportet e mëparshme të ZKA-së dhe NjAB-së, dhe nga informacionet që ofrojnë qasje publike si dhe nga burime të tjera.

Planin strategjik është përpiluar në funksion të eliminimit të shkaqeve që drejojnë kahjen nga mangësitë, lëshimet dhe të metat e konstatuara në vazhdimësi duke u mbështetur në burimet e disponueshme.

2.1. Qëllimet e Komunës

Komuna rregullon dhe udhëheq çështjet publike brenda territorit të saj të përcaktuara me ligj, për të siguruar kushte për jetë normale dhe të qetë për të gjithë qytetarët. Komuna gjithashtu kujdeset për çështjet me interes të përgjithshëm që ndërlidhen me komunën dhe që nuk janë objekt shqyrtimi apo rregullimi të institucioneve qendrore apo të ndonjë organi tjetër.

Organet e Komunës së Gjakovës, kujdesen që të gjithë qytetarët e komunës t'i gëzojnë të gjitha të drejtat dhe liritë pa dallim race, etnie, ngjyre, gjinie, gjuhe, religjioni, mendimi politik, apo mendimi tjetër, prejardhjes kombëtare apo sociale, pa dallim prone, lindje apo ndonjë statusi tjetër me qëllim që ata të gëzojnë të drejta dhe mundësi të barabarta në shërbimet komunale në të gjitha nivelet.

Komuna e Gjakovës në territorin e vet, në kuadër të ligjeve ekzistuese, është, përgjegjëse dhe ushtron pushtetin mbi këto aktivitete:

- ✓ Zhvillimin lokal ekonomik;
- ✓ Planifikimin urban dhe rural;
- ✓ Shfrytëzimin e tokës dhe zhvillimin;
- ✓ Zbatimin e rregulloreve të ndërtimit dhe standardeve për kontrollimin e ndërtimit;
- ✓ Mbrojtjen e mjedisit lokal;

Njësia e Auditimit të Brendshëm

Mob. +383 (0) 44 59 69 79; e-mail: arber.gola@rks-gov.net
Adresa: Rr. "UÇK" nr. 53., Ish. Ndërtesa e Bankosit, Gjakovë

- ✓ Ofrimin dhe mirëmbajtjen e shërbimeve publike dhe shërbimeve komunale, përfshirë furnizimin me ujë, kanalizimin dhe drenazhin, trajtimin e ujërave të zeza, menaxhimin e mbeturinave, rrugëve lokale, transportit lokal dhe skemave të nxehtësije lokale;
- ✓ Përgjigje ndaj rasteve emergjente lokale;
- ✓ Ofrimin e arsimit publik parashkollor, fillor dhe të mesëm, duke përfshirë regjistrimin dhe licencimin e institucioneve edukative, punësimin, pagesën e rogoave dhe trajnimin e instruktorëve dhe administratorëve të arsimit;
- ✓ Promovimin dhe mbrojtjen e të drejtave të njeriut;
- ✓ Ofrimin e përkuqdesit publik primar shëndetësor;
- ✓ Ofrimin e shërbimeve familjare dhe shërbimeve të tjera të mirëqenies sociale, siç është përkuqdesi për të cënueshmit, strehimin familjar, përkuqdesin fëmijëror, përkuqdesin për të moshuarit, duke përfshirë regjistrimin dhe licencimin e këtyre qendrave të përkuqdesit, punësimin, pagesën e rogoave dhe trajnimin e profesionistëve të mirëqenies sociale;
- ✓ Banimin publik;
- ✓ Shëndetësinë publike;
- ✓ Licencimin e shërbimeve publike dhe objekteve, duke përfshirë ato që kanë të bëjnë me argëtimin, aktivitetet kulturore dhe të lira, ushqimin, strehimin, tregjet, shitesit në rrugë, transportimin lokal publik dhe taksitë;
- ✓ Emërimin e rrugëve, rrugicave dhe vendeve të tjera publike;
- ✓ Ofrimin dhe mirëmbajtjen e parqeve dhe hapësirës publike;
- ✓ Turizmit;
- ✓ Aktivitetet kulturore dhe të lira;
- ✓ Çdo gëshje që nuk është përjashtuar shprehimisht nga kompetenca e tyre, apo që nuk i është paracaktuar një autoriteti tjetër.

2.2. Ndryshimet e pritura në Komunë

Plani strategjik do të azhurnohet për çdo vit dhe do t'i përshtatet ndryshimeve, të cilat do të ndodhin gjatë periudhës tri-vjeçare të cilat mund të rrjedhin si rezultat i miratimit të ligjeve, strategjive lokale, ndryshimeve në strukturën organizative të Komunës, mundësisë së transferimit të kompetencave nga niveli qendror në atë lokal dhe përdorimit më efikas të sistemeve të IT-së të instaluara në Komunë.

2.3. Niveli i kontrollit në Komunë

Menaxhmenti ka arritur të krijojë procedura të shkruara dhe të vendos kontroll funksionale në shumicën e aktivitetëve që zhvillohen në komunë. Faza e tanishme është ngritja e vazhdueshme e nivelit të kontrollëve ekzistuese, ngritja e përgjegjësisë ndaj detyreve të punës që të ketë efekt pozitiv në arritjen e objektivave të përgjithshme të Komunës. Raportet e ZKA-së dhe NJAB-së me të gjeturat dhe rekomandimet japin informacione dhe udhëzime të vazhdueshme të cilat menaxhmenti t'i për dorë për të përmirësuar kontrollin e brendshme.

III. OBJEKTIVAT STRATEGJIK TË NJËSISË SË AUDITIMIT TË BRENDSHËM

Në bazë të kuptuarit tonë të objektivave, prioriteteve, aktiviteteve dhe nivelit të kontrollit në organizatë gjatë periudhës 2025 - 2027, NJAB ka identifikuar objektivat strategjik në vijim:

3.1 Objektivat kryesore të Planit Strategjik:


- ✓ Përkufizimi i 'universit të auditimit që përfshin të gjitha fushat/aktivitetet e organizatës të cilat i nënshtrohen auditimit të brendshëm;
- ✓ Ofrimi i qasjes objektive të bazuar në rrezik për përkufizimin e punës së AB-së;
- ✓ Asistimi i NJAB-së në dhënien e sigurisë së arsyeshme mbi funksionimin e sistemeve të kontrollit të brendshëm në organizatë;
- ✓ Lejimi i NJAB-së që të optimizojë përdorimin e burimeve të saja dhe të përmirësojë efektivitetin e saj si shërbim për menaxhmentin;
- ✓ Prezantimi i standardeve dhe treguesve të cilët mund t'u ndihmojnë auditoreve të brendshëm në matjen e avancimit në punën e tyre dhe në arritjen e qëllimeve të veçanta strategjike dhe;
- ✓ Demonstrimi tek menaxhmenti se aktivitetet e auditimit të brendshëm realizohen në mënyrë kompetente.

IV. UNIVERSI I AUDITIMIT

Me qëllim të përmbushjes së objektivave strategjike të auditimit, përcaktohen edhe fushat e veprimit për auditim, në baze të strategjisë duke përdorur qasjen strukturore të aprovuar me skemën organizative të Komunës.

Organogrami i Komunës së Gjakovës

SHTOJA NUMER: 2



Nr.	Struktura në fokus
1	Drejtoria e Administratës
2	Drejtoria për Buxhet dhe Financa
3	Drejtoria për Shërbime Publike
4	Drejtoria për Infrastrukturë
5	Drejtoria për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale
6	Drejtoria për Arsim
7	Drejtoria për Kulturë, Rini dhe Sport
8	Drejtoria për Zhvillim Ekonomik
9	Drejtoria për Urbanizëm dhe Mbrojtje të Mjedisit
10	Drejtoria për Bujqësi, Pylltari dhe Zhvillim Rural
11	Drejtoria për Gjeodezi, Kadaster dhe Pronë
12	Drejtoria për Mbrojtje dhe Shpëtim
13	Drejtoria për Inspektim
14	Njësia për Menaxhimin e Burimeve Njerëzore
15	Njësia e Prokurimit
16	Sektorit për Menaxhimin e Kontratave dhe Zhvillim të Projekteve

Njësia e Auditimit të Brendshëm
 Mob.+383 (0) 44 59 69 79; e-mail: arber.gola@rks-gov.net
 Adresa: Rr. "UÇK" nr. 53, Ish. Ndërtesa e Bankosit, Gjakovë

V. VLËRËSIMI I RREZIKUT

5.1 Faktorët e rrezikut dhe rëndësia e tyre

Faktorët e rrezikut që vendosin për angazhimet me prioritet janë: cilësia e kontrolleve të brendshme, kompleksiteti dhe madhësia e operacioneve, ndikimi financiar, koha e angazhimit të fundit të auditimit, rregullativat ligjore ose kontraktuale, ndërrimet e fundit në aktivitet ose procese, kompetenca e menaxhmentit, marrëdhëniet e punonjësve dhe ekzekutivit komunal, lëvizja e personelit, ndryshimet e aktiviteteve dhe strukturës së komunës, amendamenti i rregulloreve, kompleksiteti i rregulloreve, etj. Varësisht nga ndikimi që kanë faktorët (FRR) e cekur më lartë në paraqitjen e rrezikut për nga forma e paraqitjes mund të jenë:

1) Rreziku për reputacion, 2) Rreziku i operimit, 3) Rreziku strategjik, 4) Rreziku legjislativ, 5) Rreziku kontraktual, 6) Rreziku financiar dhe 7) Rreziku menaxherial.

Prandaj duke i analizuar faktorët e rrezikut dhe kategoritë e mundshme të paraqitjes së rrezikut për secilën fushë të auditimit, do të bëhet vlerësimi i rrezikut për çdo fushëveprim të auditimit për periudhën tre vjeçare duke u bazuar në gjykimin profesional të auditorit të brendshëm.

Tabela e përkufizimit të faktori të rrezikut		
<i>Faktorët e Rrezikut FRR¹</i>	<i>Kategoritë i Rrezikut</i>	<i>Rëndësia</i>
FRR1	Rreziku për reputacion	0.20
FRR2	Rreziku organizativ	0.20
FRR3	Rreziku legjislativ	0.10
FRR4	Rreziku strategjik	0.15
FRR5	Rreziku kontraktual	0.05
FRR6	Rreziku financiar	0.15
FRR7	Rreziku menaxherial	0.15

5.2 Shkalla e gradimit

Shkalla e gradimit për faktorët e rrezikut në planin Strategjik 2025-2027, do të jetë më e ultë 1 (një) dhe më e larta deri në 3 (tre).

Me qëllim të përcaktimit të nivelit të rrezikut kemi bërë analizën e faktorëve të rrezikut për të gjitha sistemet dhe njësitë të cilat janë të përfshira në këtë plan strategjik (Shkalla e Gradimit * Faktori i Rrezikut = Vlerësimi i Rrezikut).

¹ Numri, rëndësia dhe faktori i rrezikut ndryshon varësisht nga Kategoria e Rrezikut

5.3 Kufijtë e prioritetizimit

Në rast se indeksi për rrezikun minimal është 1 dhe indeksi për rrezikun maksimal është 3, Udhëheqësi i NjAB-it duke u bazuar në gjykimin profesional ka zgjedh pragjet e mëposhtme:

Vlerësimi i Rrezikut nga Nj/AB për vitet 2025-2027										Kriteri															
Nr	Faktori i Rrezikut	1 FRR	2 FRR	3 FRR	4 FRR	5 FRR	6 FRR	7 FRR	Tregues i	Rrezik i Lartë 2.31 - 3.00				Rrezik i Mesëm 1.71 - 2.30				Rrezik i Ulët 1.00 - 1.70							
Rëndësia										0.20		0.20		0.10		0.15		0.05		0.15		0.15		1	
										1	2	3	4	5	6	7	Index								
1	Drejtoria e Administratës	2	2	2	3	2	1	1	1	1.85															
2	Drejtoria për Buxhet dhe Financa	3	3	3	3	3	2	2	2	2.70															
3	Drejtoria për Shërbime Publike	3	2	2	3	2	2	3	3	2.50															
4	Drejtoria për Infrastrukturë	3	3	3	3	3	2	2	2	2.70															
5	Drejtoria për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale	2	1	1	1	2	1	1	2	1.40															
6	Drejtoria për Arsim	2	1	1	1	1	1	1	2	1.35															
7	Drejtoria për Kulturë, Rimi dhe Sport	3	3	3	3	2	3	3	2	2.70															
8	Drejtoria për Zhvillim Ekonomik	3	3	3	3	2	3	3	2	2.70															
9	Drejtoria për Urbanizëm dhe Mbrojtje të Mjedisit	1	1	2	2	2	1	1	2	1.40															
10	Drejtoria për Buqësi, Pylltari dhe Zhvillim Rural	3	3	3	3	2	3	3	2	2.70															
11	Drejtoria për Gjeodezi, Kadaster dhe Pronë	3	2	1	2	1	1	3	3	2.05															
12	Drejtoria për Mbrojtje dhe Shpëtim	1	2	1	2	1	1	1	1	1.35															
13	Drejtoria për Inspektim	2	2	1	2	1	2	1	1	1.70															
14	Njësia për Menaxhimin e Burimeve Njerëzore	3	2	1	2	2	1	2	2	1.95															
15	Njësia e Prokurimit	3	3	3	3	3	3	3	3	3.00															
16	Sektori për Menaxhimin e Kontratave dhe Zhvillim të Projekteve	3	3	3	3	3	3	2	2	2.70															

Sistemet me indeksin e rrezikut prej 2.31 deri në 3.00 janë rreziqe të larta;
 Sistemet me indeksin e rrezikut prej 1.71 deri në 2.30 janë rreziqe mesatare;
 Sistemet me indeksin e rrezikut prej 1.00 deri në 1.70 janë rreziqe të ulëta.

5.4 Rezultatet nga vlerësimi i rrezikut

Vlerësimi i Rrezikut nga NjAB për vitet 2025-2027						Kriteri						Shkalla e Rrezikut	efektive e punës / ditë
						Rrezik i Lartë		2.31 - 3.00					
						Rrezik i Mesëm		1.71 - 2.30					
						Rrezik i Ulët		1.00 - 1.70					
Nr	Faktori I Rrezikut	FRR 1	FRR 2	FRR 3	FRR 4	FRR 5	FRR 6	FRR 7	Tregues i	Index			
Fushat e Auditimit		Gjasat											
Rëndësia		0.20	0.20	0.10	0.15	0.05	0.15	0.15	1				
		Grd	Grd	Grd	Grd	Grd	Grd	Grd	1 - 3				
1	Njësia e Prokurimit	3	3	3	3	3	3	3	3.00	L	30		
2	Drejtoria për Zhvillim Ekonomik	3	3	3	2	3	3	2	2.70	L	30		
3	Drejtoria për Bujqësi, Pylltari dhe Zhvillim Rural	3	3	3	2	3	3	2	2.70	L	30		
4	Sektori për Menaxhimin e Kontratave dhe Zhvillim të Projekteve	3	3	3	3	3	2	2	2.70	L	30		
5	Drejtoria për Infrastrukturë	3	3	3	3	3	2	2	2.70	L	30		
6	Drejtoria për Kulturë, Rini dhe Sport	3	3	3	2	3	3	2	2.70	L	30		
7	Drejtoria për Buxhet dhe Financa	3	3	3	3	3	2	2	2.70	L	30		
8	Drejtoria për Shërbime Publike	3	3	3	3	3	2	2	2.70	L	30		
9	Drejtoria për Gjeodezi, Kadaster dhe Pronë	3	2	1	2	1	1	3	2.05	M	20		
10	Njësia për Menaxhimin e Burimeve Njerëzore	3	2	1	2	2	1	2	1.95	M	20		
11	Drejtoria e Administratës	2	2	2	3	2	1	1	1.85	M	20		
12	Drejtoria për Inspektim	2	2	1	2	1	2	1	1.70	U	15		
13	Drejtoria për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale	2	1	1	1	2	1	2	1.40	U	15		
14	Drejtoria për Urbanizëm dhe Mbrojtje të Mjedisit	1	1	2	2	1	1	2	1.40	U	15		
15	Drejtoria për Arsim	2	1	1	1	1	1	2	1.35	U	15		
16	Drejtoria për Mbrojtje dhe Shpëtim	1	2	1	2	1	1	1	1.35	U	15		

Njësia e Auditimit të Brendshëm

Mob.+383 (0) 44 59 69 79; e-mail: arber.gola@rks-gov.net
 Adresa: Rr. "UÇK" nr. 53., Ish. Ndërtesa e Bankosit, Gjakovë

VI. QASJA E AUDITIMIT

Në periudhën e auditimit 2025 - 2027 NJAB synon t'i mbulojë të gjitha njësitë që auditohen dhe vlerësohen me rrezik të lartë, të mesëm dhe të ulët, mirëpo kjo është direkt e varur nga kapacitetet njerezore të NJAB-së, me që rast për vitin 2025 do të fokusohemi vetëm tek ato me rrezik të lartë, duke shpresuar që me rritjen e kapaciteteve të auditohen edhe njësit/fushat të vlerësuara me rrezik të mesëm dhe të ulët.

6.1. Shpeshësia²

Proceset e vlerësuara me shkallë të rrezikshmërisë së lart janë të parapara të auditohen gdo vit.
Proceset e vlerësuara me shkallë të rrezikshmërisë së mesme parashihen të auditohen gdo të dytin vit.
Proceset e vlerësuara me shkallë të rrezikshmërisë së ulët parashihen të auditohen gdo tri vite.

RREZIKU I LARTË

Njësia e Prokurimit
Drejtoria për Zhvillim Ekonomik
Drejtoria për Buqësi, Pylltari dhe Zhvillim Rural
Sektori për Menaxhimin e Kontratave dhe Zhvillim të Projekteve
Drejtoria për Infrastrukturë
Drejtoria për Kulturë, Rini dhe Sport
Drejtoria për Buxhet dhe Financa
Drejtoria për Shërbime Publike

RREZIKU I MESËM

Drejtoria për Gjeodezi, Kadaster dhe Pronë
Njësia për Menaxhimin e Burimeve Njerëzore
Drejtoria e Administratës

RREZIKU I ULËT:

Drejtoria për Inspektim
Drejtoria për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale
Drejtoria për Urbanizëm dhe Mbrojtje të Mjedisit
Drejtoria për Arsium
Drejtoria për Mbrojtje dhe Shpëtim

² Shpeshësia e auditimeve pavarësisht shkallës së rrezikshmërisë është direkt e varur nga kapacitetet njerezore të NJAB-së.

Njësia e Auditimit të Brendshëm

Mob: +383 (0) 44 59 69 79; e-mail: arber.gola@rks-gov.me
Adresa: Rr. "UÇK" nr. 53, Ish. Ndërresa e Bankosit, Gjakovë

6.2. Kohëzgjatja e detyrave të auditimit

Detyrat e auditimit për shërbime sigurie – kohëzgjatja standarde duhet të përcaktohet në ditë pune për person varësisht nga vlerësimi i rrezikut. Në këtë rast llogaritjet janë bërë vetëm për 1 auditor (udhëheqësi i NjAB-së):

VLERËSIMI I RREZIKUT	DITËT PËR DETYRËN E AUDITIMIT	2025 - 2027
Rreziku i lartë	30 ditë për aktivitet të auditimit	30 ditë x 3 vite = 90 ditë
Rreziku i mesëm	20 ditë për aktivitet të auditimit	20 ditë x 3 vite = 60 ditë
Rreziku i ulët	15 ditë për aktivitet të auditimit	15 ditë x 3 vite = 45 ditë

Përcjellja e rekomandimeve – një kohëzgjatje standarde për 30 ditë të punës është përcaktuar për përcjelljen e implementimit të rekomandimeve.

Llojet e tjera të punës së auditimit:

Kohëzgjatja standarde e llojeve të tjera të punës së auditimit 10 – 20 ditë pune, si:

- veprimet e veçanta të përcjelljes së auditimit,
- auditime të paparashikueshme AD HOC,
- auditimi i kualitetit të punës,
- deyra këshilluese
- angazhimet në aktivitetet, punëtori, trajnime të auditorëve

6.3. Ndarja e detyrave për auditorë

Meqenëse aktualisht NjAB në Komunën e Gjakovës operon vetëm Udhëheqësi i Njesisë atëherë ndarja e detyrave është si në vijim:

Njësia e Auditimit të Brendshëm

Mob. +383 (0) 44 59 69 79; e-mail: arber.gola@rks-gov.net
Adresa: Rr. "UÇK" nr. 53., Ish. Ndërtesa e Bankosit. Gjakovë

7.2. Ndarya e detyrave të auditimit për 3 vite dhe ditë për person, të nevojshme për implementimin e tyre

VII. NEVOJAT E AUDITIMIT PËR PERSONEL

Auditorët	1				Udhëheqësi i NJAB
	2	Totali i ditëve të punës	248 ^a		
	3	Pushimi vjetor	25		
	4	Pushimi mjekësor	10		
	5 = 2 -	Koha efektive e punës	213		
	6	Trajnim dhe kualifikim	30		
	7	Aktivtete Administrative	15		
	8	Planifikim strategik dhe	10		
	9	Monitorim periodik	10		
	10	Auditimet e mëhershme	8		
Implementimi I detyrave të auditimit		Shërbime Këshilluese	10		
		Përcjellja e Rekomandimeve	10		
			12		
		13=5	(6)+7+8+9+10+11+12)		120

I lartë	2.31- 3.00	4	5	5
I mesëm	1.71 - 2.30	0	0	1
I ulët	1.00 - 1.70	0	0	1

Aktualisht NjAB në Komunën e Gjakovës funksionon vetëm me një auditorë i cili është Udhëheqësi i NjAB-së, sidoqoftë, në konsultim me Kryetarin e Komunës dhe Njësinë për Menaxhimin e Burimeve Njerëzore jemi dakorduar që gjatë vitit 2025 të zhvillohen procedurat e rekrutimit për dy (2) auditor të brendshëm.

Njësia e Auditimit të Brendshëm

Mob.+383 (0) 44 59 69 79; e-mail: arber.gola@rks-gov.net
 Adresa: Rr. "UÇK" nr. 53., Ish. Ndërtesa e Bankosit, Gjakovë

Z. Florent Koci

Kryesuesi i KA-së

23/12/2024

Z. Ardian Gjini

Kryetari i Komunës

Udhëheqësi i NJAB-së

Z. Arber Gola

#	Njësia e Prokurimit	2025	2026	2027	Ditë punë për person strategjik	Ditë punë për person strategjik	Ditë punë për person strategjik	Ditë punë për person strategjik
1	Njësia e Prokurimit	3	1	30	1	30	30	30
2	Drejtoria për Zhvillim Ekonomik	L	3	1	30	30	30	30
3	Drejtoria për Bujqësi, Pyllkari dhe Zhvillim Rural	L	3	30.00	1	30	30	30
4	Sektori për Menaxhimin e Kontratave dhe Zhvillim të Projekteve	L	3	1	30	30	30	30
5	Drejtoria për Infrastrukturë	L	3	1	30	0	0	30
6	Drejtoria për Kulturë, Rini dhe Sport	L	3	1	30	30	30	30
7	Drejtoria për Buxhet dhe Financa	L	3	1	30	30	30	30
8	Drejtoria për Shërbime Publike	L	3	1	30	30	30	30
9	Drejtoria për Qjodëz, Kadasiter dhe Pronë	M	2	1	25	25	25	25
10	Njësia për Menaxhimin e Burimeve Njerëzore	M	2					
11	Drejtoria e Administratës	M	2					
12	Drejtoria për Inspektim	U	1					
13	Drejtoria për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale	U	1					
14	Drejtoria për Urbanizëm dhe Mbrojtje të Mjedisit	U	1					
15	Drejtoria për Arsium	U	1	15	15			
16	Drejtoria për Mbrojtje dhe Shpëtim	U	1					
17	Sipas kërkesës së ZKA-së	L	3					
Totali për deyrat në pajtim me vlerësimin e rezultatit dhe strategjinë e auditimit								
		4	120	150	7	190	190	190
	Implementimi i deyrave të auditimit nga NJAB		120	150				
	Trajnim dhe Kualifikim		30	20				
	Aktivitetet Administrative		15	20				
	Planifikimi strategjik dhe vjetor		10	15				
	Monitorimi periodik		10	15				
	Auditimi i menjëhershëm		8	15				
	Shërbime Keshilluese		10	15				
	Percjellja e Rekomandimeve		10	20				
	KOHA E VEKTIME E PUNES (KEP)		213	270				
	KEP/Numri i Auditoreve / Viti		213	270				
	KEP/Numri i Auditoreve		213	270				
	Numri i auditoreve të nevojshëm		3	3				
	Pozitat e zëna të punës		1	1				
	Numri shishtë i auditoreve të nevojshëm		2	2				

Njësia e Auditimit të Brendshëm

Mob.+383 (0) 44 59 69 79; e-mail: arber.gola@rks-gov.net
Adresa: Rr. "UÇK" nr. 53., Ish. Ndërtesa e Bankosit, Gjakovë

